

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



01

RINCAMP 2025, MUZHAQI: NË QENDËR TË VËMENDJES, SHËNDETI MENDOR I TË RINJVE

Në Jalë u zhvillua kampi veror RinCamp 2025, një traditë tashmë e konsoliduar e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Për pesë ditë me radhë, 100 të rinj nga i gjithë vendi u bënë pjesë e një platforme të veçantë që i bashkoi për të mësuar, për të ndarë përvoja dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi mes tyre. Edicioni i këtij viti u përqendrua tek shëndeti mendor i të rinjve, një nga çështjet më të ndjeshme dhe më të rëndësishme të kohës.

Përmes një nisme novatore, pjesëmarrësit patën mundësinë të ndanin shqetësimet e tyre në mënyrë anonime, për t'u trajtuar dhe diskutuar nga psikologë të ftuar. Kjo qasje u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të brezit të ri për të përballuar vështirësitë dhe për të ndërtuar vetëbesim. Ministrja për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, theksoi se "kampi përbën një moment të veçantë për të rinjtë, jo vetëm për të njohur programet dhe nismat që i mbështesin, por edhe për të dhënë ide dhe propozime konkrete për politikat rinore". Ajo vuri në dukje se ky format frymëzues krijon mundësi reale për socializim, bashkëpunim dhe projekte të reja mes të rinjve në shkallë kombëtare e rajonale.

Gjatë ditëve të kampit u zhvilluan sesione të hapura diskutimi me profesionistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale, si dhe aktivitete praktike që forcuan aftësitë personale, emocionale dhe shoqërore të pjesëmarrësve. Nga roli i të rinjve si motor ndryshimi, tek dialogu institucional dhe trajnimi mbi mirëqenien mendore, RinCamp dëshmoi edhe njëherë fuqinë e përfshirjes rinore. RinCamp 2025 mbetet një model i angazhimit rinor dhe i bashkëpunimit me institucionet, duke e parë rininë si partner strategjik në ndërtimin e një Shqipërie më të fortë, më të shëndetshme dhe më të përfshirë për të gjithë.



02

PROJEKTET FITUESE TË ORGANIZATAVE NGJA THIRRJA V – MUZHAQI: MBËSHTETJE ME PROGRAME TË REJA PËR MBI 25,000 TË RINJ NË MBARË VENDIN



Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, nënshkroi kontratat me organizatat fituese të Thirrjes V, për zbatimin e 32 projekteve në 42 bashki të Shqipërisë. Këto nisma do të fokusohen në teknologji, sipërmarrje, kulturë, sport, mirëqenie sociale dhe përfshirje qytetare, duke sjellë mundësi të reja për mbi 25,000 të rinj në gjithë vendin.

Ministrja Bora Muzhaqi e vlerësoi këtë si një tjetër hap konkret në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, duke theksuar se përgjatë katër thirrjeve publike të shpallura nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë, janë financuar 85 projekte të organizatave, që kanë mbështetur mbi 43,600 të rinj në 61 bashki të Shqipërisë. Ky angazhim i vazhdueshëm dëshmon përkushtimin për të fuqizuar rininë shqiptare dhe për të krijuar hapësira zhvillimi në çdo cep të vendit.

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik




03

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ASPA PËR TRAJNIMET E DEDIKUARA GJATË PROGRAMIN KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS. NJË HAP I RI PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË TË RINJVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për trajnimin e 600 praktikantëve që do të jenë pjesë e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Ky program, nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, është një nismë konkrete për përgatitjen profesionale dhe integrimin e të rinjve në tregun e punës. Thirrja e X-të është e hapur për aplikime për 45 ditë dhe ofron më shumë mbështetje se kurrë më parë për të rinjtë që kërkojnë një pikënisje drejt karrierës profesionale.

Ministrja Bora Muzhaqi theksoi se ky bashkëpunim do t'u ofrojë të rinjve module të dedikuara mbi aftësitë ndërpersonale dhe digjitale, sjelljen organizative, financat publike, etikën dhe rregullat e administratës publike, duke i përgatitur më mirë për karrierën e tyre profesionale.

"Ajo që po ndërtojmë sot është një gjeneratë praktikantësh që do ta nisë karrierën shumë më e përgatitur se gjeneratat e mëparshme," u shpreh Ministrja. Pjesëmarrësit do të angazhohen sipas fushës së tyre të studimit, duke fituar eksperiencë pune të drejtpërdrejtë dhe njohuritë e nevojshme për të qenë konkurrues në tregun e punës. Ky hap dëshmon angazhimin e Qeverisë shqiptare për t'u ofruar të rinjve mundësi konkrete zhvillimi dhe integrimi të suksesshëm profesional.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT PËR
RININË DHE FËMIJËT

04

RAPORT MONITORIMI VJETOR I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR RININË - 86% REALIZIM ME PROGRAME ME NDIKIM REAL PËR TË RINJTË

RAPORT MONITORIMI

PËR ZBATUESHMIKUN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË 2022-2029

PERIUDHA JANAR - DHJETOR 2024

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët publikoi Raportin e Monitorimit Vjetor të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029, duke shënuar një realizim prej 86% të masave të planifikuara për vitin 2024. Raporti dëshmon se reformat dhe programet e zbatuara kanë sjellë ndikim real për të rinjtë, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së tyre, inovacionit, mirëqenies dhe arsimimit. Ministrja Bora Muzhaqi theksoi se ky dokument është një hap i rëndësishëm për transparencë dhe llogaridhënie publike, duke treguar qartë çfarë është premtuar dhe çfarë është realizuar. Raporti i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare: riniafemijet.gov.al/media/dokumente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



05

ECOYOUTH – TË RINJTË SI AKTORË KYC DUKE NDIKUAR DREJTPËRDREJT NË KRIJIMIN E NJË MJEDISI MË TË PASTËR DHE MË TË QËNDRUESHËM

Në Elbasan u zhvillua konferenca Ecoyouth - "Zëri i Gjellbër i të Rinjve", organizuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Rrjetin e Profesionistëve të Rinj dhe Kongresin Kombëtar Rinor. Kjo nismë, pjesë e Laboratorit të Ballkanit Perëndimor të RCC-së, synon të krijojë role të posaçme për të rinjtë që do të përfaqësojnë interesat mjedisore në Këshillat Vendorë Rinorë. Ministria Bora Muzhaqi vlerësoi se kjo është një mundësi e re për të rinjtë që, përtej thirrjeve për mbrojtjen e mjedisit, të bëhen pjesë e vendimmarrjes, duke ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e një mjedisi më të pastër dhe më të qëndrueshëm.



06

NISMAT KOMUNITARE, VIZIONI I TË RINJVE NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT, REHABILITOHET QENDRA SHËNDETËSORE FRANKTH NË MAT

Të rinjtë e Bashkisë Mat, të udhëhequr nga Brus Hysenlikaj, realizuan rehabilitimin e Qendrës Shëndetësore Frankth në kuadër të projektit "Connected - Building Bridges, Creating Futures". Me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë, dhe financimin e British Council, kjo nismë solli një ndryshim konkret për komunitetin, duke dëshmuar fuqinë e të rinjve për të sjellë transformime të qëndrueshme.

Falë ligjit të ri "Për Rininë", Programi i Nismave Komunitare do të mbështesë edhe grupe joformale të të rinjve, duke u dhënë mundësinë të zhvillojnë projekt-ide të tyre në shërbim të komunitetit, me financim të dedikuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Ky është një shembull frymëzues se si vizioni i të rinjve shndërrohet në veprime që përmirësojnë jetën e përditshme të qytetarëve.



REPUBLIKA E SHQIPËS
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



07

KONKURSI KOMBËTAR "RRËNJËT E MIA" – ARTI I TË RINJVE SHNDËRROHET NË ZË PËR IDENTITETIN

Kur arti i të rinjve, i shprehur përmes fotografisë, shndërrohet në zë për identitetin, komunitetin dhe sfidat e migracionit. Ministria për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në Konkursin Kombëtar të Fotografisë "Rrënjët e Mia", një nismë frymëzuese që i dha të rinjve mundësinë të shprehin përmes artit historitë e tyre mbi identitetin, komunitetin dhe sfidat e migracionit. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit "Forcimi i Kapaciteteve Institucionale Vendore për Migracionin në Shqipëri", mbështetur nga Qeveria britanike.

Së bashku me ambasadorin britanik Nicholas Abbot dhe drejtoreshën e IOM Albania, Alma Jani, Ministria diskutoi me të rinjtë mbi migracionin e parregullt dhe vlerësoi rëndësinë e krijimit të mundësive për të ndërtuar një të ardhme të sigurt pranë vendit. Në ekspozitën e organizuar, u prezantuan 10 fotografitë më të mira, ku finalistët ndanë historitë pas imazheve të tyre, duke e shndërruar konkursin në një moment frymëzues reflektimi dhe shprese.



08

TAKIM INFORMUES ME STUDENTËT E FAKULTETIT TË DREJTËSISË PËR MUNDËSITË E REJA TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Ministria për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, e cila u prit nga dekanë e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Prof. Dr. Dorina Hoxha, zhvilloi një takim informues me studentët e këtij fakulteti për Thirrjen X të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Programi i cili i ofron 600 profesionistëve të rinj një praktikë 3-mujore me kompensim financiar dhe trajnime të dedikuara nga ASPA, do t'i japë mundësinë 250 praktikantëve që do të shfaqin rezultate më të mira, mundësinë për të përfutur kontratë 1-vjeçare të punës në institucionet ku do të zhvillojnë praktikën. Studentët e vlerësuan faktin se programi është i hapur për të gjithë, jo vetëm për ekselentët, duke e bërë atë një mundësi të vlefshme për çdo të ri që dëshiron të hedhë hapat e parë drejt karrierës në administratën publike përmes platformës praktika.riniafemijet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT